



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 46

Datë: 29. 08. 2024 ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së
2. Raport i Këshillave të KQZ

2.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrit të vendvotimeve dhe numrit maksimal të votuesve;

3. Të ndryshme !

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari **Kreshnik Rdoniqi**, e hapi takimin e 46 të KQZ të këtij viti. Pasi që paraqiti agjendën, Arianit Elshani tha se pika e dytë e rendit të ditës nuk është shqyrtuar nga KOZ, dhe të shqyrtohet si pikë e veçantë...

Pas këtij propozimi, me 11 për, u miratua rendi i ditës.

2.Raport i Këshillave të KQZ

Shqyrtimi dhe miratimi i listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, numrit të vendvotimeve dhe numrit maksimal të votuesve:

Burim Ahmetaj, drejtor i Sekretariatit tha se është punuar me zyrtarë të Ministrisë e Punëve të Jashtme me qëllim të krijimit të listës së Qendrave të Votimit që do të përdoren si “QV” jashtë vendit. E kemi përgatitë edhe një listë me numrin e VV: do të jenë 35 QV, dhe 47 VV.

Kjo, është e konfirmuar nga MPJ për 22 shtete.

Është përcaktuar edhe numri i votuesve brenda një vendvotime. Ne, kemi propozuar që numri të jetë sipas asaj që e ka dhënë KQZ. Mirëpo, ka një propozim nga MPJ që të ketë një numër tjetër...

Gordana Llaban: Në listë, nuk gjendet ambasada e Kosovës në Serbi. E dimë që nuk ka ambasadë: Si t’ua shpjegojmë qytetarëve të Kosovës që janë në Serbi si të votojnë ? A ka ndonjë formë që të bëhet kjo...? Cila është ajo mënyrë që qytetarët ta dinë...?

Burim Ahmetaj: Deri sa nuk kemi numër të votuesve në një vend, sa votues janë, ka qenë e vështirë të përcaktohem se a mund të kemi një lokacion. A mund të votohet në zyrën ndërlidhëse në Beograd. Nuk kemi informacione të mjaftueshme, dhe fizikisht, nuk kemi ditur ku ti hapim lokacionet...

Gordana Llaban: Nës jo fizikisht, atëherë si mund të votojnë ndryshe...?

Burim Ahmetaj: Të gjithë votuesit i kanë mundësitë përmes postës, ku mund të votohet edhe përmes Fahut Postal të shtetit që aplikojnë... Kjo, është edhe kosto më e lehtë e shpenzimeve. Por, edhe direkt në Fahun Postar të KQZ.

Këto, edhe janë tri mundësitë e votuesve jashtë Kosovës.

Sami Kurteshi, diskutoi gjerë e gjatë lidhur me “numrin” e votuesve në Vendvotim. Ai, bëri një analizë të propozimeve mes KQZ dhe MPJ rreth numrit. Ka një kolezion, një disproporcion dhe unë propozoj diçka që ndoshta është edhe si ‘kompromis’, mirëpo nuk është kompromis! Ne, e kemi propozue një shifër: “47, 000”. Por, unë mendoj se ky numër nuk do të arrihet, sepse ka mundësi më të lehta, forma tjera.

Unë propozoj të hapet platforma dhe ata, të deklarohen se për cilën formë duan të votojnë. Vetëm që, numri i propozuar prej ‘47, 000’ mos të kufizohet! Pra, sot të hapet platforma vetëm se, mos të kufizohet numri dhe, të tjerët të mos mund të regjistrohen...

Meqë, kemi kohë, e shohim si rrjedh procesi. Unë mendoj se nuk mbërrihet numri. Por nëse arrihet numri, ne me vendim të KQZ shohim se ose hapim një vendvotim të ri ose të votojnë me postë' nëse, nuk ka mundësi fizike...

Alban Krasniqi: Për mua është e qartë, propozimi është i qartë...

Kreshnik Radoniqi: Patëm dy propozime: një, që të kufizohet numri i votuesve në vendvotim, dhe një propozim që të mos kufizohet numri...

Kemi propozimin e Sekretariatit, dhe atë të z. Kurteshi...

Alban Krasniqi, tha se propozimi i i Sekretariatit nuk ka kaluar në filtra të duhur. Propozimi i MPJ që ka ardhur dje, nuk është trajtuar në sekretariat dhe neve, në mënyrë arbitrare që tash po na bartet, po na mbivendoset neve si propozim... Nuk është shqyrtuar në mënyrë profesionale fare ! Propozimi i z. Kurteshi, ka logjikë. Kjo që ka sjellë sekretariatit, madje unë as se kam në imell...Në rendin e ditës, nuk ishte dje...Sido që të jetë, propozimi i z. Kurteshi të vendoset fillimisht... Unë mendoj që heqja e kufizimit, mundëson një të drejtë elementare, të ligjshme, kushtetuese dhe shumë demokratike.

Ekzistojnë procedura mes marrëdhënieve mes dy shteteve, dhe është ministria kompetente dhe ne nuk mund ti japim asaj mësim...

Ndër të tjera, Krasniqi tha se vendosja e përkufizimit është një lloj diskriminimi që në fillim i votuesve.

Arianit Elshani, tha se më 26 të këtij muaji, është mbajtur takim mes sekretariatit dhe ministrisë jashtme, ku isha edhe unë. Kjo listë e sekretariatit ka marrë pëlqimin e tyre, pra ka pas dakordime në parim mes dy institucioneve. Por, tash për shkaqe teknike janë dërguar edhe propozime tjera, por që konsiderojmë që nuk janë konform procedurave të KQZ.

Ne, nuk kemi në Kosovë kapacitete për aq shumë votues me një vendvotim, e lëre ma në përfaqësi diplomatike, tha ndër të tjera z. Elshani.

Ilir Gashi, tha se ne kemi dokumentet tona mbi të cilat veprojmë. Edhe ligjin e ri që, është votuar me konsensus në Kuvend, dhe ne duhet ta respektojmë...Ai, citoi ligjin që, thotë se ku duhet të jetë Qendra e Votimit, kushtet e përfaqësive diplomatike, si dhe cakton numrin e votuesve për secilën vendvotim. Pra, është KQZ ajo që duhet ta zbatojë ligjin, rregullat tona të brendshme...

Ne, e përcaktojmë numrin...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: **Ibrahim Selmanaj, Sami Kurteshi, Sami Hamiti** i cili tha se tash vijmë në situatën “1000, e cilit i themi të votojë...? Janë përcaktuar normat, është formati, tha z. Hamiti. Pastaj, diskutoi **Kreshnik Radoniqi**, dhe sërish **Alban Krasniqi**.

Qemailj Kurtis, tha se unë kam dilema dhe nuk di nga t’ia fillojë! Duhet filluar nga kushtetuta, nga të drejtat e garantuara dhe, secili ka të drejtë të votoj, Unë, jam angazhuar që sa më shumë votues tanë të jetojnë. Fatkeqësisht, janë pak ata që lajmërohen, që votojnë. E dimë se si ata kanë votuar në zgjedhjet e kaluara. Mua, më brengosë fakti se si realizohet ligji. Jemi angazhuar shumë, dhe ne duhet t’i respektojmë të drejtat. Do të ishte gabim nëse si respektojmë rregullat që vet i kemi hartuar dhe, miratuar. Duhet të shohim si të dalim nga kjo, e të mos i dëmtojmë votuesit tanë...

Fazli Stollaj, tha se, ne po përpiqemi të përcaktohem për QV-të. Pe përkufizojmë numrin e votuesve. E mbështesë propozimin e Samiut që të mos kemi kufizime. Secili që aplikon ta zgjedh të drejtën e vet, dhe në bazë të kriterëve që i vendos KQZ, do të përcaktohet KQZ, të paktën nëse tejkalohej numri... Të hapet sot platforma, por mos të kufizohet numri. Nëse e mbërrin numrin “1000” mos të kufizohet teknikisht pastaj...

Diskutimet kishin të bënin kryesisht, me format, procedurat, aspektet teknike, të hapësirave, me numrin e votuesve etj.

Në fund, z. **Kreshnik Radoniqi** tha se, janë dy propozime:

1. Miratimin e Listës së Qendrave të Votimit Jashtë Kosovës, Numrin e Vendvotimeve dhe Numrin Maskimal të Votuesve.
2. E kemi numrin “1000” por që mos me u kufizue teknikisht.

Për propozimin e parë votuan 7 anëtarë, 1 kundër (Alban Krasniqi)...

Për propozimin e dytë të z. Sami Kurteshi votuan 4 anëtarë. (Sami Kurteshi, Ibrahim Selmanaj, Alban Krasniqi dhe Fazli Stollaj).

Kaloi propozimi i parë.

3. Të ndryshme!

